



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 13.7.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Eficienca energjetike - programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”.
4. Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. (vazhdon shqyrtimi nen për nen).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Eduard Halimi, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Mucmataj, Anila Agalliu, Gent Strazimiri, Petrit Vasili, Arben Ristani, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Dashamir Peza, Silva Caka, Tom Doshi, Mhill Fufi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Elona Mistrovica – përfaqësuese e Ministrisë së Financave.

Illir Bejtja - zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë.

Agim Bregasi - drejtor i Politikave të Zhvillimit Elektro-energjetik në MEI.

Enea Karakaçi - përgjegjës i sektorit juridik në MEI.

Miranda Lila - këshilltare e ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

Anisa Pina - specialiste e medies në MEI.

Plarent Ndreca - sekretar i Përgjithshëm i MAS-it.

Aleksandër Xhuvani - anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë.

Erzen Tola - drejtor i Drejtorisë Juridike në MAS.

Erjon Muharremaj - këshilltar Juridik i Komisionit të Arsimit të Lartë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit, meqë është plotësuar kuorumi. Sot, në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjeve:

- “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”.

- “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Eficiencia energjetike - programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”.

- Vazhdimin e shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Para fillimit të mbledhjes, për të gjithë ata që janë të interesuar, natyrisht, në radhë të parë për anëtarët e komisionit dhe për fansat e konsensusit, dëshiroj t’ju bëj me dije se sot kemi pasur një takim me zotin Halimi, në vijim të seancës plenare të ditës së enjte dhe kemi rënë dakord që Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë të përbëhet nga 10 anëtarë (5 anëtarë nga maxhoranca dhe 5 anëtarë nga pakica parlamentare).

Gjithashtu, kemi rënë dakord të bëhet një ndryshim në pikën 6, ku do të theksohet shprehimisht se Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë do të organizojë veprimtarinë e tij i mbështetur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit për funksionimin e komisioneve parlamentare. Në rast të mosplotësimit të kuorumit, mbledhja zhvillohet me praninë e njërit prej anëtarëve zëvendësues. Përgjatimisht, në rastin kur votimi është i barabartë, vota e kryetarit të komisionit është vendimtare, duke respektuar në çdo vendimmarrje standardet ndërkombëtare të transparencës dhe gjithëpërfshirjes, në konsultim me ekspertizën ndërkombëtare përfshi edhe komisionin e Venecias. Besoj se është pozitive që edhe opozita më në fund, bëhet pjesë e këtij komisioni të rëndësishëm që ka në fokus një nga reformat më të rëndësishme në vend, atë në fushën e drejtësisë.

Unë shpresoj dhe besoj se roli i opozitës në këtë proces do të jetë konstruktiv, në funksion të nevojës që ka vendi dhe të pritshmërisë së lartë që kanë qytetarët për reformimin e sistemit të drejtësisë. Gjithsesi, shpresoj që kjo të jetë një marrëveshje ose një ndryshim i vendimit

të Kuvendit, jo si një akt formal, por do t'i shërbejë thelbit, substancës, përmbajtjes, qëllimit që ka ky proces, i cili tashmë ka filluar dhe është realizuar në një pjesë të mirë të kërkesave dhe detyrimeve që ka pasur nga vendimmarrja e Kuvendit në ngritjen e këtij komisioni. Natyrisht, një rrugë e gjatë mbetet përpara. Shpresoj dhe besoj shumë që ne do ta realizojmë atë me shumë sukses, sepse para se të jetë një proces që ka të bëjë me fatet e integritetit të mëtejshëm të vendit, është një proces që ka të bëjë me fatet e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe me interesat e qytetarëve të këtij vendi.

Faleminderit!

Zoti Halimi, keni fjalën!

Eduard Halimi – Edhe unë desha të them dy fjalë. Dua të falënderoja partnerët ndërkombëtarë që bënë të mundur realizimin e një marrëveshjeje të tillë, duke u nisur dhe nga zhvillimet e seancës së fundit parlamentare, mbas takimeve të zhvilluara në këtë mëngjes, u ra dakord që Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë do të jetë paritar, pra, me numër të barabartë anëtarësh nga shumica dhe pakica parlamentare dhe përjashtimisht, në rastin kur votimi është i barabartë, vota e kryetarit të komisionit do të jetë *double vote*, duke pasur parasysh që procesi të përputhet me standardet europiane. Shqetësimi i opozitës ka qenë i kahershëm dhe ka pasur të bëjë me respektimin e standardeve europiane, të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe ekspertizës ndërkombëtare në ecurinë e kësaj reforme. Për këto çështje, kryetari nuk do të përdorë votën *double*, pra, do të ketë një respektim të padiskutueshëm të këtyre standardeve dhe ne u dakordësuar për të vijuar më tej, sepse kjo është një reformë shumë e rëndësishme për të cilën opozita për herë të parë në këto 10 vjet është bërë pjesë e procesit konstruktiv të reformës në drejtësi dhe shpresojmë që kjo reformë së bashku dhe me komisionin tjetër për dekriminalizimin, i cili drejtohet nga opozita, do të ecin paralelisht.

Sa i përket këtij procesi, unë do të doja të falënderoj partnerët, ashtu sikundër edhe kryetarin e komisionit, që u treguan fleksibël dhe arritëm në një marrëveshje shumë të rëndësishme për vendin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Mund të vazhdojmë me rendin e ditës. U lutem përfaqësuesve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të vijnë!

Zoti Bregasi, kur të mbyllet reforma, presim urime unë personalisht, por besoj edhe zoti Halimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ta shohim, mos kini paragjykime!

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, zotin Bejtja, zotin Bregasi, zotin Karakaçi dhe zonjën Miranda, për praninë e tyre!

Ju lutem, zoti Bejtja të na bëni një përmbledhje të të dy projektligjeve, sepse kanë të njëjtën fokus, për të kursyer kohën, por edhe sepse janë të njohura për deputetët për shkak se ata kanë pasur mundësi në kohë të njihen me to.

Faleminderit!

Zoti Bejtja, keni fjalën!

Ilir Bejtja - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Tri marrëveshjet që po paraqesim sot kanë për qëllim jo vetëm mbështetjen e sistemit të energjisë elektrike, por edhe rritjen e bashkëpunimit midis sektorit publik të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe atij privat, duke garantuar për herë të parë një fond efience, në mbështetje nëpërmjet sistemit bankar, të garantuar me marrëveshje me qeverinë gjermane (KfW-në), që do të shërbejë në fushën e rritjes së eficiencës së energjisë elektrike jo thjesht për gjeneruesit publikë, por edhe për ata privatë.

Qëllimi i projektit është aplikimi me impakt të gjerë dhe i qëndrueshëm i një instrumenti financiar në sistemin bankar shqiptar, me qëllim dhënien e mbështetjes për investime në kursimin e energjisë, në sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, në banesat private dhe nëse është rasti, edhe në komuna apo në bashki. Aplikimi i këtij instrumenti do të çojë si në thellimin dhe zgjerimin e sistemit financiar shqiptar, si dhe në reduktimin e konsumit të energjisë elektrike dhe në këtë mënyrë, do të kontribuojë edhe për mbrojtjen e klimës. Ky financim u shkon bankave të nivelit të dytë, të cilat do të mbështesin në mënyrë specifike projektet në fushën e eficiencës, pa bërë dallim midis operatorëve privatë dhe publikë.

Marrëveshja e dytë ka të bëjë me një grant, i cili shërben për mbarëvajtjen e kaskadën së Drinit, për sigurinë në diga. Edhe kjo marrëveshje është në kuadër të marrëveshjes financiare

të vitit 2009, që ne kemi pasur me KfW-në dhe me qeverinë gjermane. Vlera e saj është 20 milionë euro dhe do të shërbejë për rritjen e sigurisë në kaskadën e Drinit.

Marrëveshja e tretë i referohet rritjes së eficiencës së energjisë elektrike në transmetim, duke plotësuar kuadrin me tri marrëveshjet, duke prekur 3 sistemet: gjenerimin, transmetimin dhe shpërndarjen.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti zëvendësministër për ekspozenë e bërë!

Zoti Muçmataj, keni fjalën si relator i projektligjit!

Vexhi Muçmataj - Faleminderit, zoti kryetar!

Të dyja marrëveshjet janë në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Për këtë arsye, duke i parë në tërësi, jam i mendimit t'i kalojmë në parim, duke rezervuar të drejtën që gjatë shqyrtimit nen për nen, të propozojmë ndonjë ndryshim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje?

Janë dy marrëveshje: njëra lidhet me huan e sektorit bankar dhe tjetra është për sektorin e transmetimit.

Zoti Fino, keni fjalën!

Bashkim Fino – Në relacion lexoj se komponenti i parë dhe ai i dyti janë:

- Ndërtimi i një linje të re 220 kV me dy qarqe midis Tiranës dhe Rashbullit;
- Forcimi dhe zgjerimi i nënstacionit të Rashbullit dhe Tirana 2;
- Ndërtimi i një nënstacioni të ri 220/110 kV Rrogozhinë;

E katërta, që e shoh në të gjitha marrëveshjet dhe asnjëherë s'e kam marrë vesh sesa janë (këtë pyetje e kam edhe për ju zoti kryetar), se vërtet reforma në drejtësi është e rëndësishme, por janë disa gjëra që kalojnë poshtë reformës në drejtësi, që janë: shërbimet e konsulencës. Shërbimet e konsulencës i shikoj në të gjitha marrëveshjet. Sa është shuma për shërbimet e konsulencës dhe sa përqind zënë ato, në raport me vlerën totale që duhet për linjën e Rashbullit apo asaj që duhet për ndërtimin e nënstacionit të ri? Jam kurioz ta di këtë vlerë, sepse në përgjithësi jepet vetëm me një fjali, pa dhënë hollësi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Bejtja, keni fjalën!

Ilir Bejtja - Faleminderit!

Zakonisht këto shuma vendosen në funksion të tipit të marrëveshjes dhe të investimit që kryhet. Varet nga ekspertiza që kemi në sistemin energjetik, lidhur me projektin i cili zbatohet. Në marrëveshje të tilla ky zë shkon 2-5%. Me kredinë e BB-së kemi qenë në nivelin 5%. Nuk është përcaktuar akoma se çfarë përqindjeje do të zërë. Kjo varet nga punët që do të ketë. Janë 3 projekte, 3 njësi menaxhimi projektesh, të cilat përgatisin termat e referencës. Nëse ka nevojë për konsulencë për përgatitjen e tyre, merret ajo. Pra, kjo varet nga tipologjia e projektit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Ka diskutime? Nuk ka.

Vazhdojmë me votimin e projektligjeve. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Vazhdojmë votimin nen për nen.

Neni 1.

Urdhëroni!

Vexhi Muçmataj – Te neni 1, në fund të paragrafit, të shtohen fjalët: “sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Jeni dakord me nenin 1 me këtë ndryshim? Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me konsensus kjo marrëveshje.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Eficiencia energjetike - programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Faleminderit!

Vazhdojmë votimin nen për nen.

Neni 1.

Urdhëroni!

Vexhi Muçmataj – Te neni 1, përsëri në fund të paragrafit, të shtohen fjalët: “sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Jeni dakord me nenin 1 me këtë ndryshim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Falënderoj, zotin zëvendësministër dhe kolegët e tij!

Gjithë të mirat!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 13.7.2015, ora 10:30

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar komisioni

Rendi i ditës:

Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. (Vazhdon shqyrtimi nen për nen).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Eduard Halimi, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Mucmataj, Anila Agalliu, Gent Strazimiri, Petrit Vasili, Arben Ristani, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Dashamir Peza, Silva Caka, Tom Doshi, Mhill Fufi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Plarent Ndreca - sekretar i Përgjithshëm i MAS-it.

Aleksandër Xhuvani - anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë.

Erzen Tola - drejtor i Drejtorisë Juridike në MAS.

Erjon Muharremaj - këshilltar Juridik i Komisionit të Arsimit të Lartë.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me projektligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” do të vijojmë shqyrtimin nën për nen të tij.

Jemi te neni 75.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Neni 75 bën fjalë për pranimet në programet e ciklit të dytë. Jemi dakord në parim me këtë nen. Kam vetëm një pyetje që duhet sqaruar, sepse këtu thuhet që kriteret e pranimi përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit, por nuk thuhet se kush i miraton këto kriteret. Pra, pyetja ka të bëjë me pikën 3, të nenit 75.

Fatmir Xhafaj – Kush i përcakton kriteret e pranimi në programet e integruara të studimit?

Zoti Ndreca keni fjalën!

Plarent Ndreca - Faleminderit, zoti kryetar!

Pika 3 ka për qëllim rregullimin e momentit se kush i vendos kriteret e pranimi. Është njësia bazë ajo që e bën këtë. Më pas janë organet e tjera të IAL-së që bëjnë miratimin, si senati.

Fatmir Xhafaj – Besoj se është e qartë.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

A do të ishte më mirë të themi, që miratimi i tyre bëhet sipas kriterëve të caktuar në statutin e institucioneve? Këtu thuhet vetëm që kriteret e pranimi në program bëhen nga njësia bazë, por miratimi do të bëhet nga institucione të ndryshme.

Plarent Ndreca – Kjo është sqaruar te kompetencat e senatit. Megjithatë, nuk kam kundërshtim ta saktësojmë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Kalon neni 75. Neni 76.

Vasilika Hysi – Kisha dhe një pyetje të shkurtër te neni 75: A është gjithë e mirë që studentët kanë të drejtë të bëjnë transferim brenda të njëjtës njësi? Ju keni shtuar këtu: “edhe midis njësive të ndryshme”, te pika 4.

Fatmir Xhafaj – Te IAL-të?

Vasilika Hysi – Po.

A mund të ndodhë që një student të regjistrohet në një degë, që nuk është prioritare dhe më pas, në vitin e dytë ai të kalojë në një degë tjetër të ngjashme me të? Këtu kemi një kalim nga një degë jo e rëndësishme, në një degë më të rëndësishme, për të cilën ka pasur më shumë konkurrencë në pranim. A krijon pabarazi ky lloj transferimi?

Plarent Ndreca – Nuk besoj. Ne nuk mund të kufizojmë lirinë e transferimit të studentëve. Sigurisht, transferimi në një degë prioritare nga një degë normale, do të sjellë për rrjedhojë mospërfitimin e atyre privilegjeve, që ka pjesëmarrja në këtë degë.

Vasilika Hysi – Është në rregull. Pyeta është sa për qartësim dhe për të mbetur si rekord: a mundet një student i masterit ekzekutiv, të kalojë në doktoraturë?

Një shqetësim tjetër i dalë nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, pjesa e ekspertëve që merren me reformën për arsimin e lartë, ku përfshihet edhe EURALIUS, për titujt në doktoraturë, do të regjistrohen vetëm, ata që janë punonjës kërkimorë-shkencorë dhe mësimdhënës në fakultet, apo do të kenë të drejtë të regjistrohen edhe persona të tjerë, që mund të jenë gjyqtarë, prokurorë, juristë të sektorit privat, avokatë?

Mora si shembull arsimin juridik, por ky problem mund të lindë edhe për degët e tjera të shkencës.

Plarent Ndreca – Sigurisht, një që ka mbaruar master ekzekutiv, mund të kërkojë të futet në programin e tretë të studimeve, por nuk i njihet asnjë kredit. Pra, nuk është se i njihet ndonjë kredit, siç ishte në legjislacionin aktual për masterin e nivelit të dytë.

Referuar dispozitës 76, kemi kufizuar të drejtën, që të marrin pjesë në doktoraturë vetëm ata që janë në proces mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor. Është gjykuar nga komisioni dhe ekspertët e fushës, që nuk mund të bëjnë kërkim shkencor ata që janë të angazhuar qoftë në profesione të lira apo në administratën publike.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Kalon neni 76.

Neni 77, që flet për pranimin në programet e ciklit të tretë.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 78, “Studimet e doktoratës”.

Vasilika Hysi – Këtu kam të njëjtën pyetje që kisha për miratimin e kriterëve.

Fatmir Xhafaj – Besoj se edhe ju, keni të njëjtën përgjigje.

Faleminderit!

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 79, “Programet e përbashkëta të studimit”.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 80, “Programet e studimeve dhe të formimit të vazhduar”.

Vasilika Hysi – Këtu i jepet më shumë kompetencë, sepse programet e studimeve dhe të formimit të vazhduar, i miraton njësi bazë, pra, ju keni menduar që nuk ka nevojë të shprehet senati, nëse e kam kuptuar qartë.

A është e qartë, sepse në dispozitë nuk rezulton se kush do t’i miratojë këto programe të studimeve dhe të formimit të vazhduar? Të gjitha programet miratohen në senat, thuhet në fillim. Edhe ju kështu e konfirmuat. Në rastin e këtyre programeve nuk shpreheni. Ia keni lënë departamentit pra, njësisë bazë?

Plarent Ndreca – Besoj se po flasim për pikën 2 të nenit 80. Këtu thuhet: “Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi bazë përgjegjëse”. Nuk po flasim për kriteret e pranimit, por po flasim për strukturën, për kohëzgjatjen dhe për kreditet. Nuk janë e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 81, “Programet e studimit në fushën e mësuesisë”.

Vasilika Hysi –Zoti kryetar,

Këtu është sugjeruar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, grupi i ekspertëve të huaj dhe shqiptarë, që merren me reformën për arsimin e lartë, ku përfshihet edhe EURALIUS, që programet e studimeve në fushën e drejtësisë të rregullohen në një nen më vete, meqenëse është propozuar të futen si studime të integruara. Nëse do të më lejoni, do të lexoj formulimin e këtij neni të ri me titull: “Programet e integruara të studimit në fushën e drejtësisë”.

Fatmir Xhafaj – Do të jetë pas nenit 81?

Vasilika Hysi – Jo, do të jetë midis neneve 80 dhe 81.

“1. Programet e integruara të studimit në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, në një kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

2. Personat që kanë realizuar studimet e integruara në drejtësi ose një program të ciklit të dytë të studimeve ose të barasvlershme me to, mund të vazhdojnë kualifikimet në shkollat e larta profesionale për përgatitjen si gjyqtarë, prokurorë avokatë, avokatë të shtetit, përmbarues privat ose shtetërorë, ndërmjetës si dhe juristë në sektorin publik, pasi të kenë kaluar provimin kualifikues shtetëror në drejtësi.

3. Provimi kualifikues shtetëror organizohet nga Ministria e Arsimit dhe ajo e Drejtësisë mbi bazën e rregullores për organizimin e provimit kualifikues shtetëror në drejtësi, e cila miratohet me VKM”.

Përfshirja e këtij neni, që është analog me nenin që rregullon studimet në fushën e mësuesisë, kërkon që edhe në pjesën e dispozitave tranzitore të shtojmë edhe një nen tjetër, i cili do të përcaktojë afatin e miratimit të rregullores nga Ministria e Arsimit dhe ajo e Drejtësisë dhe periudhën kur do të fillojë zbatimi i kësaj dispozite”.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord?

Faleminderit që jeni dakord në parim! Më pas, mund ta shikoni më në detaje.

Jeni dakord me nenin 81? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Jeni dakord me nenin 82? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Jeni dakord me nenin 83? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 84, “Kodifikimi i programeve të studimit”.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Kjo dispozitë në fakt, ka disa elemente pozitive. Më së fundi i jepet fund programeve që nuk janë të koduara dhe kanë larmishmëri, gjë që vështirëson transparencën për të gjithë ata që duan të regjistrohen dhe vë në diskutim disa çështje, të cilat nëse nuk kuptohen ose nuk thuhën qartë, mund të cenojnë lirinë akademike.

Pyetja e parë, ka të bëjë me kodifikimin. Në paragrafin e parë thuhet, që kodifikimi i programeve të studimit bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Me fjalën “kodifikim” keni parasysh thjesht, numërtimin, kodin apo ka të bëjë me diçka më shumë, se përcaktimi i kodit?

Fatmir Xhafaj – Patjetër.

Vasilika Hysi – Pyetja e dytë: nëse ka diçka më tepër, vihet në diskutim liria akademike, sepse në nenin 4 të këtij ligji dhe në gjithë vazhdimësinë dhe në të gjithë përvojën 4-vjeçare të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë, programet i hartojnë vetë universitetet. Kjo është liria akademike, e drejta për të hartuar programet e tyre.

E dyta: është futur një element i ri që programet e studimit ofrohen në të njëjtën fushë studimi, duhet të kenë një përmbajtje të ngjashme në nivelin 70%. Lindin dy pyetje.

E para: Kush do të merret si program bazë referues, i cili do të shërbejë për të përafruar dhe për të sjellë programet në një shkallë ngjashmërie deri në nivelin 70%?

Ju thoni që këtë do ta bëjë KM-ja. A mundet KM-ja të përcaktojë përmbajtjen e një programi apo të të gjitha programeve, që kanë të gjitha IAL-të e të gjitha fushave, në të gjithë Shqipërinë?

A është cenim i lirisë akademike fakti që KM-ja duhet të përcaktojë përmbajtjen se çfarë duhet të përmbajë program i drejtësisë, i mjekësisë apo i degëve të tjera?

Ky është një nga shqetësimet që unë kam, lidhur me këtë nen.

Plarent Ndreca – Ky nen ka vetëm një qëllim: menaxhimin sa më të mirë në rang kombëtar të të gjitha programeve të studimit dhe në fakt i gjithë informacioni do të jetë në mënyrë të natyrshme nga IAL-të. Pra, ministria vetë nuk prodhon informacion, por ajo do të jetë përgjegjëse për kodifikimin, për menaxhimin e të gjitha programeve, që të mos ketë asnjë paqartësi dhe asnjë dyshim mbi llojet e programeve dhe në kushtet kur nga ana e QSHA-së do të ketë një menaxhim në rang kombëtar, ky ka qenë qëllimi që të kemi nga një kod për të gjitha programet në rang kombëtar dhe nuk ka për qëllim që ministria apo KM-ja të hyjnë në thelbin e programeve.

Vasilika Hysi – Faleminderit për sqarimin! Jam dakord.

Atëherë, lind nevoja të bëjmë një riformulim të pika 3 e këtij neni, e cila thotë: “Hapja e një programi të ri studimi shoqërohet me përcaktimin e kodit, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Specifikimet për kodifikimin e programeve të studimit dhe përmbajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Po thamë që specifikimet për kodifikimin e programeve të studimit dhe përmbajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, atëherë, duhet ta rregullojmë.

Plarent Ndreca – Po themi “specifikimet për kodifikimin e programeve të studimit” dhe jo të programit. Është e shkruar kështu.

Vasilika Hysi – Fjalja vazhdon: “...dhe përmbajtjen e tyre”.

Plarent Ndreca – Po themi: “... specifikimet për kodifikimin e programeve të studimit dhe përmbajtjen e tyre”. Nëse gjykoni që duhet rregulluar, patjetër.

Ideja është që po flasim për kodifikimin.

Vasilika Hysi – Jam absolutisht dakord që kështu duhet të jetë, por nëse do të lëmë një dispozitë të paqartë, kjo mund të na çojë më pas në keqinterpretime. Me këtë që thoni ju, është më se e saktë. Te specifikimi: “...për kodifikimin e programeve të studimit dhe përmbajtjen e tyre”, fjala e fundit është e programeve dhe jo “e kodifikimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Me këtë jam dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Kalon neni 84 me ndryshimin që iu bë.

Kalojmë te neni 85, “Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies”.

Jeni dakord me nenin 85? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 86, “Gjuha e studimeve”.

Vasilika Hysi – Këtu kisha vetëm një saktësim terminologjik: aty ku thuhet:

“ofrohen normalisht”, të vendoset: “si rregull”.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Kalon neni 86 me ndryshimin që iu bë.

Neni 87, “Transferimi i studimeve. Njohja dhe njësimi i periudhave të studimit”.

Vasilika Hysi – Këtu kisha pyetjen që bëra pak më parë, e cila u sqarua.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Kalon neni 87.

Neni 88. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 89, “Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 90. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te Kreu VIII, “Kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë”. Neni 91, “Veprimtaria kërkimore-shkencore”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 92.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse sapo e lexuat, titulli i këtij kreu është kërkimi shkencor në IAL-të. Nëse hyjmë në përmbajtjen e nenit 92, tentohet të rregullohet veprimtaria kërkimore-shkencore jo vetëm në IAL-të (te pika “a”), por edhe në 2 tipe institucionesh të tjera: institutet dhe qendrat institucionale të kërkim-zhvillimit dhe institutet e kërkim-zhvillimit pranë ministrive. Ky është një ligj për arsimin e lartë dhe fusha e veprimtarisë së tij që në fillim është përcaktuar. Me këtë ligj rregullohet kërkimi shkencor në IAL-të. Nëse do të marrim përsipër të rregullojmë veprimtarinë kërkimore shkencore në institucionet, që mund të krijojnë ministritë e tjera, që s’kanë lidhje me arsimin e lartë, shtrohet pyetja: A mundet me një ligj specifik për arsimin e lartë të rregullojmë kërkimin shkencor edhe në institucionet që kanë lidhje dhe janë jashtë arsimit të lartë. Kjo lidhet edhe me nenin 94, i cili specifikon që kërkimi shkencor mund të kryhet nga institucione publike apo private kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, me marrëveshje midis tyre? Kjo nuk ka lidhje me arsimin e lartë, pra del jashtë kompetencës dhe qëllimit të këtij ligji. Bashkë me këtë lidhet edhe çështja e financimit.

Fatmir Xhafaj – Ç’lidhje ka kjo, se të them të drejtën, nuk po e kuptoj. Këtu thuhet: “... sipas ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë këto veprimtari”. Kush është problemi?

Vasilika Hysi –Ky është një ligj për arsimin e lartë. Titulli është: “Kërkimi shkencor në IAL-të”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por do të ketë një pikë lidhjeje me këtë, sepse kjo është Ministria e Arsimit, e cila drejton të gjithë kërkimin shkencor. Nuk do të ketë një pikë lidhjeje me të gjitha këto institucione?

Urdhëroni!

Plarent Ndreca – Është specifikuar në nenin në vijim, që flasim gjithmonë në kushtet e marrëveshjes midis institucioneve me njëra-tjetrën. Disa IAL mund të bëjnë marrëveshje për të ndërtuar një qendër ndër-institucionale mes tyre për kërkim shkencor. Pra, gjithmonë flasim brenda suazës së arsimit të lartë.

Edhe Ministria e Mbrojtjes ka Akademinë e Mbrojtjes, e cila është një IAL, që varet nga Ministria e Mbrojtjes që mund të ketë një qendër kërkimore- shkencore, ashtu siç mund të ketë edhe një ministri tjetër, si Ministria e Brendshme, që ka Akademinë e Rendit. Këto të dyja mund të lidhin një marrëveshje për bashkëpunim kërkimor-shkencor.

Vasilika Hysi - Me sqarimin që jepni ju, është e saktë. Kjo kërkon rregullimin e nenit 94, sepse aty flitet që ky bashkëpunim mund të bëhet edhe pa marrëveshjen e IAL-ve. E lëmë ta diskutojmë, kur të vijmë te neni përkatës.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 92? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 93, “Kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë”.

Kush është dakord me nenin 93? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 94, “Institutet dhe qendrat ndërinstitutionale të kërkim-zhvillimit”.

Vasilika Hysi - Këtu ka vend pyetja që shtrova. Në pikën 1 thuhet: “Institutet dhe qendrat ndërinstitutionale të kërkim-zhvillimit krijohen nga dy apo më shumë IAL ose institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike e private, me marrëveshje midis tyre”. Pjesa e parë e fjalisë është e saktë. Në pjesën e dytë të fjalisë mungon pika e lidhjes, që e thatë edhe ju, me një IAL.

Fatmir Xhafaj – Dakord, po këtu thuhet: “IAL ose institucione kërkimore-shkencore, kulturore”.

Vasilika Hysi – Jo, aty thuhet institucionet publike e private, në marrëveshje midis tyre”. Këtu duhet të qartësohet dhe duhet të jetë patjetër një IAL.

Fatmir Xhafaj – Mesa kuptoj unë duhet të jetë: “Institutet dhe qendrat ndërinstitutionale të kërkim-zhvillimit krijohen nga dy apo më shumë IAL ose/edhe me institucione kërkimore-shkencore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, qartësojeni se kuptimi është i qartë.

Plarent Ndreca – Marrëveshjet janë midis 2 IAL-ve, pra, 2 subjekte të arsimit të lartë, mes 2 universiteteve, por mundet që edhe pjesë të këtyre universiteteve, pra institucione kërkimore-shkencore brenda IAL-ve, mund të bëjnë marrëveshje me njëra-tjetrën.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Vendoseni këtë në riformulim.

Neni 94 kalon me ndryshimin e sugjeruar.

Kreu IX, “Studentët dhe të dhënat mbi studentët”.

Neni 95, “Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 96, “Të drejtat dhe detyrimet e studentëve”.

Vasilika Hysi – Ky nen është në rregull, por këtu duhet shtuar e drejta që ka studenti për të zgjedhur organet drejtuese, sepse ne ia kemi dhënë konkretisht që studenti merr pjesë në zgjedhjen e dekanit dhe të rektorit. Pra, të vihet edhe këtu që është e drejta e tyre.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Vendoseni këtë.

Neni 96 kalon me ndryshimin e sugjeruar.

Neni 97, “Këshillat e studentëve”.

Vasilika Hysi – Para se të kalojmë te neni 97, ju thoni se në statutin e IAL-së mund të përcaktohen dhe të tjera të drejta dhe detyra të studentëve. Rregulli është që atë që ligji nuk ta jep, nuk mund ta vësh me akte nënligjore.

Fatmir Xhafaj – Ligji ta jep këtë. Mund të jepet, thotë.

Kush është dakord me nenin 97? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 98.

Vasilika Hysi – Unë jam dakord me nenin 98. Kam një pyetje a mund të zgjidhet me ligj?

Fatmir Xhafaj – A do ta zgjidhim punën e kartës, se është premtuar shumë që do të bëhet kështu dhe ashtu?

Vasilika Hysi – A mundemi ne me një ligj, që miratohet me shumicë të thjeshtë, të përcaktojmë detyrime për organet e qeverisjes vendore?

Këtu do të doja ndihmën e kolegut Fino, që po punon për atë ligj, sepse këtu po përcaktojmë detyrime për organet e qeverisjes vendore që të paguajnë për të gjitha përfitimet që rrjedhin nga ky ligj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me nenin 98?

Plarent Ndreca – Ky detyrim lind nga legjislacioni për transportin dhe ai për qeverisjen vendore, kështu që nuk lind vetëm nga ligji “Për arsimin e lartë”, por është një detyrim që buron dhe nga këto ligje.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Miratohet neni 98.

Kush është dakord me nenin 99, “Dokumentacioni i procesit mësimor”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 100, “Baza e të dhënave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 101 “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 102 “Sigurimi i jashtëm i cilësisë”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 103 “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 104, “Akreditimi”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te kreu XI, “Pronat dhe financimi i arsimit të lartë”.

Neni 105, “Parime bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga buxheti i shtetit”.

Vasilika Hysi – Këtu ka një ndryshim për herë të parë të parimeve bazë të financimit të IAL-ve nga buxheti i shtetit. Buxheti i shtetit i jep mundësi konkurrencës së lirë midis IAL-ve.

Kam një pyetje për pikën “a”, ku thuhet: “Parimet bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga buxheti i shtetit janë:

a) konkurrenca e lirë midis institucioneve që gëzojnë të njëjtin status, sipas përcaktimeve të nenit 16, të këtij ligji;”

Kur thoni të njëjtin status e keni fjalën që konkurrojnë midis njëri-tjetrit IAL-të publike, ato që janë jopublike dhe IAL-të e pavarura me njëra-tjetrën, apo këto gjitha këto institucione konkurrojnë në mënyrë të barabartë me njëra-tjetrën?

Plarent Ndreca – Po flasim për IAL-të publike, sepse buxheti i shtetit financon vetëm IAL-të publike. Kjo është e lidhur dhe me llojin e IAL-ve: në universitet, kolegji apo akademi.

Fatmir Xhafaj – Është e qartë. Kalojmë te neni 106, “Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 107, “Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”?

Vasilika Hysi – Ky nen është në rregull dhe është një risi që IAL-të kanë një diversitet financimesh. Kam një pyetje për pikat “e” dhe “ë”: Ju thoni që institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:

e) burime të tjera të ligjshme financimi;

ë) financime nga fonde speciale.

Cilat janë këto burime, pasi burimet e tjera janë cituar më sipër? Për pikën “ë” desha të di se cili është nocioni për “fondet speciale”.

Plarent Ndreca – Pika “ë” ka të bëjë me financimet nga vetë qeveria për fonde të caktuara për interesa shumë specifike të qeverisë, për interesa jetike të qeverisë apo të sigurisë sonë kombëtare. Për burimet e tjera të ligjshme të financimit, është lënë një hapësirë që për sa kohë burimi i financimit është i ligjshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Po mirë, ku i dihet se ç’mund të dalë nesër?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Plarent Ndreca – Ka dhe lloje të tjera financimesh, si për shembull pagesa e studentëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Qëllimi ka qenë për të krijuar hapësirën e duhur për çdo IAL. Për sa kohë financimi është i ligjshëm, të mund ta marrin atë financim. Kufizimi me 6-7 pika...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E thashë, nga qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, mund të jenë fonde të caktuara.

Fatmir Xhafaj – Mund ta riformulojmë: “donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi”.

Kush është dakord me nenin 107 me këtë shtesë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 108, “Shpërndarja e fondeve nga buxheti i shtetit”.

Vasilika Hysi – Te ky nen kam një pyetje: ju thatë pak më parë që fondet nga buxheti i shtetit ndahen për IAL-të publike. Kur thoni IAL-të publike, keni parasysh edhe këto IAL-të e pavarura, apo vetëm ato publike?

Plarent Ndreca – Fjala është vetëm për IAL-të publike.

Fatmir Xhafaj – Çfarë ka këtu të paqartë?

“Fondet nga buxheti i shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;

b) Granti i mësimdhënies;

c) Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese”.

Çfarë ke për këtë nen?

Vasilika Hysi – Unë e pyeta: A futen këtu edhe publiket e pavarura?

Fatmir Xhafaj – Ai ta pohoi. Çfarë problemi ka?

Neni 109, “Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë”.

Vasilika Hysi – Titulli është “Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë” dhe më poshtë, te pika “ b” , thoni: “fonde dhe projekte për institucionet publike të arsimit të lartë”, pra, e zgjeroni, duke përmendur “fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë”, sepse te institucionet e arsimit të lartë. Sipas pikës 16, janë edhe IAL-të jopublike.

Pra, pika “ b” del jashtë asaj që thuhet në titull, vetëm për IAL-të publike.

Herë përdorni në këtë projektligj termin IAL-të publike dhe herë përdorni IAL-të jopublike. Unë mendoj që duhen unifikuar.

Plarent Ndreca – Termi IAL është një term i përgjithshëm dhe për sa kohë rregullohet specifikisht që fondet nga buxheti i shtetit janë fonde vetëm për IAL-të publike, kuptohet që bëhet

fjalë vetëm për këtë kategori. Megjithatë, nëse ka ndonjë problem të teknikës legislative, jam dakord ta specifikojmë gjatë gjithë kohës.

Vasilika Hysi – Jam dakord me shpjegimin. A mund të themi te pika “b”: “fondet e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë”?

Në këtë kuadër, biem dakord dhe me përkufizimin dhe nuk krijohet ndonjë keqkuptim në lidhje me këtë term.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Por këto janë detaje pa rëndësi. Ai e ka thënë që në krye dhe s’mund të veprojë ndryshe.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Neni 110, “Granti i mësimdhënies”. Jeni dakord?

Vasilika Hysi – Te pika 2 thuhet: “Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë sipas një formule”. Kush e harton këtë formulë?

Plarent Ndreca – Siç është sqaruar në nenet e mëparshme, kjo bëhet nga AKFAL-i dhe nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Fatmir Xhafaj – Dakord, zonja Hysi?

Plarent Ndreca – Te neni 10, pika 3 thuhet: “Ministria përgjegjëse për arsimin miraton kriteret dhe formulat e shpërndarjes së fondeve publike të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe shpall çdo vit dokumentin e prioriteteve sipas drejtimeve kryesore”.

Vasilika Hysi – Kam dhe një pyetje: Fondet për doktoraturën do t’u jepen studentëve apo IAL-ve?

Nëse këto fonde u jepen IAL-ve, çfarë do të bëhet me një institucion jopublik, i cili bën një shpikje dhe është financuar nga shteti dhe më pas atë shpikje ua shet shtetit dhe të tjerëve? Fitimin ai do ta ndajë, sipas ortakëve në këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Pra, një IAL jopublik, i cili ka marrë financim nga shteti për fondet e kërkimit shkencor dhe nga këto fonde realizohet një fitim, shitet një patentë një shpikje. A krijohet një pabarazi mes IAL-ve publike dhe atyre jopublike?

Plarent Ndreca – Granti jepet në një mënyrë jodiskriminuese, pra në mënyrë të barabartë. Përfitimet që vijnë nga një patentë e mundshme, janë pjesë e institucionit dhe e kontratës midis institucioneve kërkimore-shkencore dhe rregullohen me ligjin e posaçëm për të drejtën intelektuale. Nuk rregullohet me këtë ligj. Këtu flasim vetëm për financim. Financimi është

i njëjtë, me të njëjtat parime dhe kritere, në mënyrë të barabartë. Më pas, sesi rregullohen përfitimet që rregullohen nga produkti, është tjetër gjë.

Mimoza Hafizi – Problemi që lind këtu është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me thelbin e ligjit dhe me përkufizimet që ka dhënë ky ligj. Studimet e doktoratës, tipet e shpenzimeve që mund të kenë ato, do t'i ndaj në 3 lloje:

1. Shpenzimet për pedagogun;
2. Shpenzimet infrastrukturore (për laboratorë, nëse flitet për kërkime shkencore);
3. Pjesëmarrja në konferenca, artikuj e kështu me radhë.

Unë e shoh kështu. Ndoshta ju mund të përcaktoni edhe ndonjë zë tjetër.

Si keni menduar t'i financoni këta 3 zëra, sepse ngarkesa e pedagogut është pjesë e veprimtarisë themelore të IAL-ve? Në përkufizimin e parë keni thënë që veprimtaria themelore e IAL-së financohet nga shteti vetëm për institucionet publike.

Plarent Ndreca – Nuk e di nëse e kuptova qartë, por ne po flasim për grantin e mësimdhënies, te neni 110.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Më falni.

Mimoza Hafizi – Gjithë këtë analizë e bëra për të thënë që ngarkesa e pedagogëve është pjesë e veprimtarisë themelore të IAL-ve. Ju në përkufizim keni thënë që kjo veprimtari themelore e IAL-ve financohet nga shteti vetëm për IAL-të publike. Pra, ka një kundërthënie mes neneve përkatëse.

Unë jam dakord nëse është fjala për 2 komponentët e tjerë, që i përkasin një grupi kërkimor-shkencor apo një individ, pra, financimet për konferenca dhe për artikuj ose financimet për laboratorë apo për diçka tjetër që shteti mendon se mund t'ia japë një grupi kërkimor-shkencor. Komponenti i parë është veprimtaria themelore e institucionit dhe nuk e di si do të ndahet ky në një institucion, qoftë ai publik apo privat. Si mund të ndahet ngarkesa e pedagogut në copa? Pjesa e veprimtarisë që bën në ciklin e parë dhe atë të dytë, dhe pjesa e veprimtarisë që bën në ciklin e tretë, ndërkohë që ngarkesa e pedagogut është pjesë e veprimtarisë themelore të IAL-së, apo siç e keni quajtur ju: funksion institucional i IAL-së.

Plarent Ndreca – Le të flasim në parim, sepse ky ligj ka vendosur disa kritere apo parime. Sigurisht, është e vërtetë që ngarkesa mësimore është e rëndësishme, por në bazë të këtij ligji do të dalin akte nënligjore, që do të sqarojnë çdo element konkret të këtij momenti.

Desha të them se ky grant në ndryshim nga grantet e tjera, përfshin edhe institucione jashtë institucioneve publike, sepse po flasim për projekte.

Në rast se një institucion jopublik ka një projekt, konkurron në mënyrë të barabartë dhe është me interes publik, sigurisht, nuk ka arsye se përse të mos financohet nga qeveria sepse produkti i atij projekti do të jetë patjetër në interes të publikut. Më pas, si do të jenë nënkategoritë, si do të bëhen formulat, këto i përkasin akteve nënligjore dhe nuk shoh asnjë kundërshti parimore mes neneve që ju përmendët.

Mimoza Hafizi – Unë mendoj se kundërshtia parimore është në përkufizimin bazë, madje zonja Hysi ka kërkuar që në seancat e para të përbashkëta që kemi bërë që ju të keni një përkufizim të neni 6 (nuk e di a e keni sjellë), për veprimtarinë e institucionit. Kështu që në qoftë se ne e kemi të qartë, që do ta ndajmë veç veprimtarinë themelore të institucionit, atëherë ky nen bëhet shumë i qartë që ne nuk financojmë studimet e doktoratës për veprimtarinë themelore të institucionit, por jemi gati të financojmë për projektet kërkimore-shkencore. Për këtë janë këto komponente: - Shpenzimet infrastrukturore (për laboratore);

- Pjesëmarrja në konferenca, artikuj e kështu me radhë.

Këto janë projekte shkencore të grupeve dhe tani vijmë në pyetjen që bëri zonja Hysi: Këto lekë do t'ia jepni institucionit apo do t'ia jepni grupit kërkimor-shkencor?

T'ia japim grupit kërkimor-shkencor nuk ka asnjë problem, sepse derisa të gjitha IAL-të i konsiderojmë të rangut universitar që kanë të drejtë të zhvillojnë kërkimin shkencor, përse të mos mbështeten në projektet konkurruese nga shteti? Por duhen mbështetur projektet dhe jo veprimtaria themelore e institucionit, pra ngarkesa e pedagogut, që nënkupton nëse ju thoni që mbështeten studimet e doktoratës.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Asgjë.

Fatmir Xhafaj – Lexon pikën 2 të nenit 111: “Pjesë e këtij granti janë edhe fondet për studimet e doktoratës, të cilat u jepen institucioneve të arsimit të lartë mbi bazën e aplikimit”.

Çfarë kishit për pikën 2?

Mimoza Hafizi – Për këtë pikë kisha problemin, që nëse ne e japim grantin për studimet e doktoratës, këtu nënkuptohet që financohet edhe veprimtaria themelore e institucionit të arsimit të lartë, e cila në nenin ...

Fatmir Xhafaj – Ju nuk e doni këtë?

Mimoza Hafizi – Ne duam të mbështeten vetëm projektet kërkimore-shkencore të doktoratës, sepse ne nuk duam të financohen IAL-të për veprimtarinë themelore. Me grantin e punës shkencore të mos financohet ngarkesa e punës së pedagogut. Këtu është në kundërtënie, sepse përzihen 2 gjëra që nuk mund të përzihen me njëra tjetrën.

Le të marrim aktualisht punën e një IAL-je jopublike. Aktualisht, ai nuk ka të drejtë të marrë fonde për studimet e doktoratës, sepse pjesa themelore e shpenzimit të tyre është ngarkesa e pedagogut. Me këtë nen i japim të drejtën një IAL-je jopublik, të marrë financime për një komponent, që nuk i takon të financohet. Ne e financojmë nëse do të ngrejë laboratorë për procesin e doktoraturës.

Fatmir Xhafaj – Nuk duhet të marrë financime për doktoraturën?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Mimoza Hafizi – Studimet e doktoraturës, në ndryshim nga një kërkim tjetër shkencor, janë nën supervizionin e një profesori, i cili paguhet për ngarkesën dhe aktualisht,

kjo është pesha themelore.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Këtë pjesë duhet ta mbulojë IAL-ja, sepse kështu është përkufizuar. Nëse ju e pranoni, jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Bashkim Fino – Edhe fondet për studimin e doktoraturës janë fonde për kërkimin shkencor.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Atë e paguan studenti.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Bashkim Fino – A mund t'i bëj një pyetje profesoreshës?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Mimoza Hafizi – Po ju shpjegoj se përse duhet ta heqim pikën 2 të nenit 110: një njeri apo një grup shkencor, qoftë një IAL publike, qoftë në një IAL jopublike, që bën një kërkim shkencor qoftë në doktoratë, qoftë jashtë doktorate, ka të drejtë të ndërtojë një projekt shkencor të aplikojë dhe të financohet nga AKFAL-i. Nuk ka pse të ndahen veç studimet e doktoratës dhe të ngatërrohet e gjithë kjo histori. Hiqeni pikën 2 dhe çdo gjë mbetet në rregull.

Plarent Ndreca – Në fondin e kërkimit shkencor është përfshirë edhe doktoratura, por jo në aspektin që ju thoni. A mund të financohet një doktorant puna e të cilit në vetvete, përbën një projekt dhe a do të financohet ai? Nëpërmjet këtyre dispozitave, ne kemi ndaluar dhënien e fondit individit, por ua kemi dhënë IAL-ve. Pra edhe individi që bën një kërkim shkencor në doktoraturë, do të aplikojë tek AKFAL-i nëpërmjet institucionit të tij, pra, neni 2 në këtë perspektivë rregullon këtë moment që edhe studimet e doktoraturës mund të financohen, si pjesë e projekteve për kërkim shkencor.

Mimoza Hafizi – Te neni 76, pika 4 keni përkufizuar që studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale dhe kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Ju keni përkufizuar që nëse një student bën studim të nivelit të tretë (doktorature), puna e tij quhet kërkim shkencor, pra atij i mbetet të hartojë një projekt dhe të shkojë te AKSHI-ja për ta marrë dhe nuk ka pse të shtoni një nen tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Më falni!

Të vihet, që nga ky grant përjashtohen pagesat e pedagogëve për punën e kryer.

Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, Klara?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Miratohet neni 111, duke u riformuluar me këtë shtesë!

Kalojmë te neni 112 “Kreditë studentore”.

Vasilika Hysi – Këtë nen e kemi lënë të hapur Plarenti se na tha , që do të na bënte një sqarim zoti Mazniku, se cili është kuptimi i ndërmjetësimit mes ministrisë përgjegjëse dhe bankave që janë private. Kur një person do të marrë një kredi në një bankë private, krijohet një marrëdhënie private midis studentit dhe bankës.

Pika 1 e nenit 112 thotë: “Ministria përgjegjëse për arsimin ndërmjetëson kreditimin e studentëve, me qëllim mbështetjen financiare për përballimin e kostos së studimeve”.

Kur shkojmë të marrim kredi në një bankë, ne nuk kemi ndërmjetës. Mund të marrësh kredi konsumatore, kredi për banesë, kredi për studime etj. Pse kërkon që ministria të marrë përgjegjësi për studentët që studiojnë në fakultetet publike dhe private dhe të jetë ndërmjetëse midis studentit dhe bankës, për të marrë një kredi? Ku e keni gjetur këtë model?

E fundit: te pika 3 thoni: “Skema e kreditimit studentor përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”. A mundet KM-ja të detyrojë një bankë private se cila do të jetë skema e financimit? Kjo është një marrëdhënie private.

Plarent Ndreca – Sa i takon pyetjes së parë, ideja ka qenë që ministria të ndërmjetësojë në nivel kombëtar me bankat, pra, të ndërmjetësojë që bëjë të mundur që studentët kenë kushte preferenciale dhe të marrin kushte preferenciale nga bankat dhe të mos ta lërë vetëm si një komunikim individual midis studentit dhe bankës, por të hyjë si ndërmjetëse vetë ministria, që të marrë oferta preferenciale në nivel kombëtar, për t’i ndihmuar studentët sa më shumë që të jetë e mundur. Sigurisht, ajo mbetet një marrëdhënie private dhe në momentin që bihen dakord për termat kryesore financiare, është një marrëdhënie që ndërtohet individualisht.

Sa i takon skemës së kreditimit studentor, nuk kemi të bëjmë me mënyrën si do të kreditohet nga bankat, por mënyra si do të ndërtohet kreditimi në nivel institucional, si do të renditet, për arsye se jo çdo student mund të marrë kredi. Dikush mund të marrë bursë nga shteti, dikush mund të marrë bursë, sepse është ekselent dhe kjo ka të bëjë me renditjen institucionale dhe nuk ka të bëjë me marrëdhënien private.

Fatmir Xhafaj – Cili është problemi nëse një qeveri cakton ministrinë për të ndërmjetësuar me bankat, për t’u dhënë kredi lehtësuese studentëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Çfarë problemi ka?

Supozojmë se ndërmjetësoi ministria.

Urdhëroni, flisni me mikrofon, se cili është problemi, nëse një qeveri cakton ministrinë për të ndërmjetësuar me bankat e nivelit të dytë, për t’u dhënë kredi lehtësuese studentëve, ashtu siç u ra dakord kohët e fundit për një kreditim për bujqësinë?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, prandaj e kalon nëpërmjet ministrit ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ç’rëndësi ka? Ç’e keqe i vjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

S’ka asgjë. Është politike.

Plarent Ndreca - Ky është një detyrim për ministrinë, e cila nuk ka asnjë përfitim, përveç përfitimin e interesit publik, për të ndihmuar studentët.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Kjo është për IAL-të publike apo edhe për ato private?

Për të gjitha?

Edhe për IAL-të private, ndërhyrje qeveria?

Bashkim Fino - Sapo më tha sekretari i Përgjithshëm, që garanci nuk jep as qeveria, as ministria. Garancinë financiare e jep studenti. Ky nën cakton që Ministria e Arsimit bie dakord me disa bankat e nivelit të dytë për t'u dhënë kredi lehtësuese studentëve. Pra, kjo është një marrëveshje xhentëlmenësh, në tryezë dhe pas kësaj marrëveshjeje, studentët që kanë nevojë drejtohen te bankat e nivelit të dytë dhe lidhin një marrëveshje pragmatiste që të marrin paratë që u duhen për të mundësuar studimin, por kështu mujore i kanë detyrim t'i paguajnë studentët. Ministria e Arsimit dhe qeveria nuk ka ndonjë detyrim në rastin konkret. Çfarë përfitohet në këtë rast? Pas kësaj a do të ketë dyndje studentësh për të marrë kredi? Ai që ka ndërmend të studiojë dhe që ka dëshirën për të studiuar dhe që ka mundësinë dhe aftësinë për të lidhur një marrëveshje kredie me bankat e nivelit të dytë, do ta bëjë patjetër këtë marrëveshje, edhe pa ndërhyrje ministria. Ky është një nën i bukur, interesant, që mund të mbetet këtu, që siç thotë sekretari i Përgjithshëm, e kanë edhe vendet perëndimore. Në praktikë kjo nuk do të sjellë asgjë. Thjesht do të bëhet një marrëveshje midis guvernatorit të bankës dhe ministrit të Arsimit ku do të bihet dakord të jepen këto kredi. Këto do të mbeten thjesht në letër. Të gjitha hapat e tjera do të jenë marrëveshje pragmatiste midis studentit dhe bankës së nivelit të dytë. Kështu e kuptoj unë këtë nën.

Plarent Ndreca – Ideja është që nëpërmjet këtij nëni ministria detyrohet të bëjë ndërmjetësimin me bankat. Supozoj që ministri përgjegjës për Arsimin mbledh të gjithë përfaqësuesit e bankave të nivelit të dytë, negocion me ta dhe lidh marrëveshje për një skemë kreditimi që është në interes të të gjitha bankave, pasi janë një masë e madhe studentësh që janë klientë të bankave dhe të gjitha palët janë të interesuara të bien në marrëveshje shumë të mirë për studentët në fund të ditës, sepse nuk është e njëjta gjë që studenti të negociojë individualisht, me rastin kur shteti vetë të ndërmjetësojë nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për kushtet dhe lehtësirave që mund të garantohen nëpërmjet kësaj kredie.

Sigurisht, mund të ndodhë që bankat mund të mos arrijnë në një marrëveshje të mirë, por kjo nuk ndalon një negociim individual. Me këtë nën e ka ngarkuar ministrinë me një detyrim

shtesë për të negociuar me bankat. Sa do t'ia arrijë qëllimit ajo, kjo është çështje tjetër. Deri dje nuk njihej fare ky detyrim dhe kjo skemë.

Fatmir Xhafaj – A merr përsipër detyrime financiare ministria? As më mbrapa?

Plarent Ndreca – Jo, nuk merr detyrime financiare.

Fatmir Xhafaj – As në nenet në vijim?

Plarent Ndreca - Jo.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 112? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 113?

Mimoza Hafizi – Në diskutimin paraparak që kemi bërë me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, kanë thënë që kreditë studentore (te pika 2), do të jenë të hapura vetëm për studimet në IAL-të publike. A do t'i mbeten kësaj, apo do të bëhet për të gjitha IAL-të? Mos është gabim e shkruar këtu, apo i mbeteni versionit të parë?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Bashkim Fino - Neni 112 është një nen shumë i bukur, që siç thotë sekretari i Përgjithshëm, e kanë edhe vendet perëndimore. Në praktikë kjo nuk do të sjellë asgjë. Thjesht do të bëhet një marrëveshje në tryezë midis bankave të nivelit të dytë dhe ministrit të Arsimit, ku do të bihet dakord të jepen këto kredi për studentët. Këto do të mbeten thjesht në letër. Të gjitha hapat e tjera do të jenë marrëveshje pragmatiste midis studentit dhe bankës së nivelit të dytë. Unë jam i mendimit që ky është një nen i bukur, që le të mbetet në ligj.

Problemi që unë kam është te neni 113, i cili thotë: “Institucionet publike të arsimit të lartë (universitetet), kanë të drejtën e marrjes së kredive për zhvillimin e tyre institucional dhe infrastrukturor.

Kushtet që duhen plotësuar për aplikim për kredinë e paracaktuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Unë nuk kam dëgjuar ndonjëherë që universitetet publike të marrin kredi, se ato financohen nga buxheti i shtetit. Përse do ta marrin këtë kredi? Për zhvillimin e tyre institucional dhe infrastrukturor? S’e kuptoj këtë.

Ç'lidhje ka kredia që do të marrë studenti, me atë që do të marrë institucioni? Pastaj ngatërrohen kreditë midis tyre. Përse do ta marrin këtë kredi IAL-ja publike, kur ajo mbahet 100% nga buxheti i shtetit?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Plarent Ndreca – Po, universitetet publike kanë të drejtë të marrin kredi.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Bashkim Fino – Është e vërtetë. S'ka asgjë për të qeshur. Hierarkia është hierarki. Problemi është se organet e pushtetit vendor janë tjetër gjë, se kanë aktivitete të zgjeruar, pra, kanë vetëm një fond nga granti i pakushtëzuar që marrin nga qeveria dhe pjesën tjetër ato e mbulojnë nga të ardhurat e veta (nga taksat, tatimet, nga aktiviteti privat), se bashkitë kanë të drejtë të zhvillojnë aktivitete privat. Meqenëse kanë të drejtë ta bëjnë këtë, dhe më parë e kemi vendosur që ato mund të marrin kredi, por me disa kushte të vendosura nga Ministria e Financave, pa i rënduar qytetarët. Ndërkohë, me ndarjen e re territoriale do të ketë disa forma të reja, do të bëhet ligji i ri i financimit për buxhetin vendor dhe nuk ka shumë lidhje me universitetet se ato kanë hapësirë ekonomike shumë më të madhe se ajo e universiteteve, sipas mendimit tim.

Unë nuk do të isha dakord marrjes së kredisë nga universitetet publike, kur ato financohen 100% nga buxheti i shtetit. Absolutisht jo. Ndërsa pushteti vendor është tjetër gjë, nuk ka lidhje me këtë. Për mendimin tim ky nen nuk është i saktë.

Më thoni ju si do ta marrin universitetet publike këtë kredi?

Plarent Ndreca – Referuar asaj që ju thatë, edhe IAL-të kanë të ardhura dhe i administrojnë ato vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, i administrojnë të gjitha vetë 100%, për zhvillimin e infrastrukturës, për paga etj. Ne nuk u ndërhyjmë dot. Përveç të ardhurave që universitetet publike kanë, edhe ne i financojmë nga buxheti i shtetit. Ky nen ka për qëllim vetëm ta hapë këtë hapësirë, t'u krijojë këtë hapësirë, por përsëri ato janë të kushtëzuara nga KM-ja. Në fund të ditës KM-ja është përgjegjëse për ekzekutimin e buxhetit të shtetit dhe është KM-ja, që e kufizon. Kredinë e marrin, por në fund është KM-ja ekzekutuese e buxhetit të shtetit. Në këtë aspekt, nuk ka asgjë të keqe që t'i hapim një hapësirë të re, të munguar, arsimit të lartë. Në momentin që ato plotësojnë kushtet dhe kriteret dhe nuk cenojnë eficiencën e buxhetit të shtetit, le ta marrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Atëherë, ka përgjegjësi Këshilli i Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Edhe ky e rrit më shumë taksën po të dojë se ka tarifën, por KM-ja është përgjegjëse për këtë. Ai ekzekuton fondet publike, pra buxhetin e shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Sigurisht, s'e ka pasur, se është risi. I është dhënë një mundësi tjetër financimi IAL-ve, nëpërmjet kreditimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Ai do të zhvillohet më tej dhe merr një kredi shtesë. Çfarë problemi ka? Për të hapur një konvikt, për shembull.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ai mund të shtojë numrin e studentëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Prandaj është VKM-ja. Prandaj e merr KM-ja përsipër atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kush është dakord me nenin 113? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 114, “Kontrolli dhe auditimi”.

Vasilika Hysi – A ta mbylлим dhe skemën e kreditimit? Te pika “c”, e nenit 10, kur thoni që ministria garanton skemën e kredive studentore, ju thatë për universitetet publike, ndërsa për skemën e kredive studentore thatë që është për të gjitha fakultetet. Si do të lihet përfundimisht? Do të jetë vetëm për publiket apo edhe për IAL-të jo publike skema e garantimit të kredive?

Plarent Ndreca – Vendimi është për IAL-të publike. Pra garantimi është përcaktuar në nenin 10, se për cilat institucione dhe nga kush institucion, ndërsa skema në parim, është që s'ka arsye pse të mos përfitojnë dhe studentët e IAL-ve jopublike.

Vasilika Hysi - Te neni 10, nuk përcaktohet që është vetëm për universitetet publike, sepse neni 10 bën fjalë për AKFAL-in. Në pikën 1 thuhet: AKFAL-i mbështet veprimtarinë e institucioneve publike të arsimit të lartë;

te pika 2 thuhet që mbështet bursat dhe te pika 3 thuhet: “bën garantimin e skemës së kredive studentore” dhe duhet shtuar: “në IAL-të publike”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 114?

Bashkim Fino – Kjo është e rëndësishme se ka të bëjë me auditimin dhe auditimi ka të bëjë shumë. Këta e lënë auditimin e brendshëm si ministri. I ka lënë Ministrisë së Financave të ketë një listë të përditësuar audituesësh për të mundësuar kontrollin e IAL-ve.

Unë desha të di këta kanë lënë auditimin e brendshëm si ministri? I ka dhënë mundësi Ministrisë së Financave të ketë një listë të përditësuar kontrollin e IAL-ve etj.

Unë desha të di nëse është KLSH-ja këtu? Më duket se nuk është.

E dyta, kontrollin e auditimit të jashtëm e cakton Ministria e Financave. Po ju vetë, si Ministri e Arsimit a keni të drejtë t'i auditoni IAL-të?

Kjo është pyetja që kisha.

Plarent Ndreca – Sa i përket KLSH-së, fusha e veprimtarisë së tij është përcaktuar në ligjin “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Besoj se kjo e mbulon edhe këtë. Ne kemi zgjedhur këtu edhe Ministrinë e Financave për shkak se është një ministri shumë më kompetente.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino pyeti se kush e kryen kontrollin e auditimit të jashtëm?

Plarent Ndreca – Kontrollin e kryen Ministria e Financave, referuar një liste audituesish të përditësuar.

Fatmir Xhafaj – Po nuk thuhet kështu në ligj: “Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në institucionet e arsimit të lartë kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, sipas një liste të përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave”. Pra, ajo ka listën e tyre, po kush i merr ata 5 auditues dhe i çon atje?

Plarent Ndreca – Ministria e Financave.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por duhet saktësuar që është përgjegjësi e Ministrisë së Financave. Ripërcaktoheni edhe këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Plarent Ndreca – Të jemi të sigurtë, nuk kemi kapacitetin e Ministrisë së Financave.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – E lamë që t'i lihet si përgjegjësi Ministrisë së Financave. Kush është dakord me nenin 115, “Pronat e institucioneve publike të arsimit të lartë”?

Besoj se ky nen nuk ka ndonjë problem.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E mbyllim këtu, sepse kemi mbledhje grupi. Të shikojmë se kur do të mblidhemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jepuni këtë që kemi kaluar.

Nesër do ta përfundojmë shqyrtimin e këtij projektligji.

Nesër në orën 9:00 do të vijojmë shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

S'ka rëndësi, do të ulemi o para, o mbrapa saj.

MBLEDHJA MBYLLET